

BIBLIOTEKA

E

SHTETILI

SSH-2

85 91

GJIROKASTER

DHIMITËR DHIMA

KUR
HAPET
PERDJA

8PI. P.85-2

S

D.S. 61

DHIMITËR DHIMA

KUR
HAPET
PERDJÄ

~~885~~

19463

BIBLIOTEKA E SHTËPIËS
GJIRBLAS FIT

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KOMPETENTI

PERSONAZHET:

Thomai
Punëtori I
Punëtori II
Përgjegjësi
Kompetenti.

(Në paraskenë)

THOMAI — Shoku përgjegjës, desha t'ju njof-toj se maqinën për shtrëngimin e rrathëve të vozave e kemi gati.

PËRGJEGJËSI — Ç'është kjo maqinë?

THOMAI — Maqina «Malo», racionalizimi im.

PËRGJEGJËSI — Pse ore, akoma s'e ke harruar ti atë, e thamë një herë, xhan i vëllait, nuk ka mundësi të bëhet ashtu siç thua ti, sepse nuk ka leverdi. Po të flas në emër të kompetentëve; ti xhan i vëllait, merru me ndonjë punë tjetër.

THOMAI — Unë po të flas në emër të punëtorëve të repartit. Tani të gjithë janë bindur se me ndryshimet që janë bërë në bazë të vërejtjeve të punëtorëve, ajo mund të vihet në përdorim.

PËRGJEGJËSI — Dëgjo, xhan i vëllait, ti e ngrite këtë edhe në mbledhje, por unë atje nuk folia, se mos ma mirrje ters, tani ty s'të mbushet mendja, mirë... Unë do të të bie edhe njerëz kompetentë të vijnë ta shikojnë.

THOMAI — Kur do të vijnë?

PËRGJEGJËSI — Ikë, se qysh tani do t'i bie, që të mos më thoni më zvarritës, indiferent, burokrat. (*Ikin në drejtime të ndryshme. Thomai takohet me një punëtor.*)

PUNËTORI I — E, shoku Thoma, ç'thotë përgjegjësi?

THOMAI — Të shohim tani çdo të na thonë kompetentët.

PUNËTORI I — Cilët janë këta kompetentë?

THOMAI — Ata që do të bjerë përgjegjësi.

PUNËTORI I — Kompetentë jemi ne që punojmë aty, po ta shikojmë ne se na e mbaron punën, ç'hyn këtu kompetenti? (*Hyn punëtori II*)

PUNËTORI II — Shoku Thoma, të lumtë, vaja ta e pashë, e përsosur fare.

THOMAI — Ju falem nderit.

PUNËTORI II — Veç asaj pashë se keni vendosur dhe një maqinë tjetër për të hapur brimat e rrathëve.

THOMAI — Mendimet dhe puna e kolektivit më kanë ndihmuar. Ne mendojmë të mekanizohem të gjitha proceset dhe puna të kryhet zinxhir. (*Hyn përgjegjësi me kompetentin*)

PËRGJEGJËSI — Shoku Thoma, akoma rrugës? (Kompetentit) Ky është shoku që ka bërë racionali-zimin.

KOMPETENTI — (i palëvizur) Çfarë pune bëni ju, shok?

THOMAI — Punëtor.

KOMPETENTI — Ç'shkollë keni kryer?

THOMAI — Vjet mbarova të tetën dhe sivjet vazhdoj të nëntën, por studjoj edhe vetë, në mënyrë të pavarur, sidomos libra dhe revista tekniko-shkencore.

KOMPETENTI — (*mbledh buzët*) Interesant!

PUNËTORI I — Pse?

KOMPETENTI — Rast tipik.

PUNËTORI II — Nga ju kemi ju, shok?

KOMPETENTI — Këndej.

PUNËTORI II — Këni marrë vesh sa shpikje kanë bërë punëtorët e të gjitha ndërmarrjeve, që nga maji e gjer tanë?!

KOMPETENTI — Kam dëgjuar, po nuk kam parë.

PUNËTORI II — Rast tipik!

THOMAI — (*përgjegjësit*) Ky është kompetenti që do të shikojë maqinën?

PËRGJEGJËSI — Po.

KOMPETENTI — Shkojmë? (*Qëndrojnë afër cepit të skenës. Jepet ideja se maqina është aty, diku afër*)

PËRGJEGJËSI — Në mos gabohem, kjo duhet të jetë maqina?

THOMAI — Po.

KOMPETENTI — Çfarë është ajo në fund?

THOMAI — Leva.

KOMPETENTI — Në ç'mënyrë shtrëngohen rrathët?

THOMAI — (*duke treguar*) Ngrofësi ose rrrafësi, që është ky këtu, ka një copë metalike, që, në-përmjet suspasionit të balestrës, ulet e ngrihet duke goditur me forcë mbi rrathët.

KOMPETENTI — Sa peshon copa metalike që bie mbi rrathët?

THOMAI — Nuk e kemi peshuar, po pesha e saj është e mjaftueshme.

KOMPETENTI — Me ç'forcë bie ajo mbi rrathët?

THOMAI — Edhe këtë nuk e kemi matur, po rrathët i shpie atje ku duam ne.

KOMPETENTI — Axhamillëqe... Kjo maqinë nuk është rentabël, nuk ka garanci dhe siguri. Nuk mund të marrë përsipër përgjegjësinë e aksidenteve që me siguri do të ndodhin.

PËRGJEGJËSI — Dhe ajo na duhet.

PUNËTORI II — Pse do të ndodhin aksidente?

KOMPETENTI — Sepse nuk është ndërtuar mbi principe pneumatike ose hidraulike, që rrrafjet të bëhen ritmike, perpendikulare dhe të mos bien tanget mbi rrathët.

PUNËTORI I — Folë më shkoqur, se s'të marrim vesh pa përkthyes.

PËRGJEGJËSI — Pushoni!.. Flet kompetenti!

PUNËTORI II — Pushoni ju, se flet maqina.

THOMAI — Shoku kompetent, kjo e kryen punën më së miri.

KOMPETENTI — E pamundur.

THOMAI — (*punëtorit të parë*) Sulë, merr një vozë dhe vëre në lëvizje maqinën. (*Dëgjohen të rahuara*) Ja, e shikoni?

KOMPETENTI — S'më bind, rrafësi bie si një pupël mbi rrathët.

PUNËTORI II — Bëjmë një provë konkrete, shoku kompetent?

KOMPETENTI — Posi, e bëjmë.

25-26

PUNËTORI II — Që ta provoni konkretisht vini dorën nën rrafës.

KOMPETENTI — Qenke shakaxhi, ti djalosh!

PUNËTORI II — Ta provoni de, ju vetë pranuat.

KOMPETENTI — (*pasi mendohet*) Pse, do të më trembni?

PËRGJEGJËSI — (*e kap nga xhaketa*) Mos, se ta preu dorën si presh.

KOMPETENTI — Ja, e zëmë se pesha e rrafësit është në rregull, por rrafjet nuk i ka ritmike; duket kjo, nuk ka rendiment. Në tetë orë ai bën a s'i bën tri katër voza, që po të m'i vësh mua përpara nuk më mbulojnë dot.

THOMAI — E keni gabim, shoku...

PËRGJEGJËSI — Pushoni, se flet kompetenti!

THOMAI — (*i flet punëtorit II*) Sulë, fillo prodhimin. (*Vozat që dalin i vë përreth kompetentit*).

PUNËTORI II — (*duke vendosur vozat*) Një, shoku kompetent... dy, shoku kompetent... tre... katër... pesë... gjashtë... (*kompetenti mbulohet*) shoku kompetent?

KOMPETENTI — (*nga prapa vozave*) Prezent.

PUNËTORI II — Doni më, shoku kompetent?

THOMAI — Sa u bënë, shoku kompetent?

KOMPETENTI — Nuk shoh më, m'i zutë sytë.

THOMAI — Jo sytë, po gojén, shoku kompetent.

KOMPETENTI — Mos vini më, se plasa.

PUNËTORI II — Ne kemi muaj që po na pëlcet shpirti duke pritur.

THOMAI — (*duke vendosur edhe një vozë*) Dale, se duhet pneumatike.

KOMPETENTI — S'ka nevojë.

PUNĒTORI II — Duhet ritmike.

KOMPETENTI — (*Nga prapa vozave*) Mjaft se më fike... I kini qarë pikën, m'u lumçin duart! (*Thomai dhe punētorët qeshin. Fillojnë t'i vënë përgjegjësit voza përreth*).

PËRGJEGJËSI — S'ka nevojë, mua m'u mbush mendja. (*Punētorët fillojnë t'i heqin kompetentit vozat. Përgjegjësi e kompetenti shikohen në sy*) Çdo bëjmë tani, shoku kompetent?

KOMPETENTI — T'ja mbathim urgjent!

NJË FLAKË KASHTË

PERSONAZHET:

Sanija
Bibliotekari
Redaktori i radios
Gazetarë
Koçua
Portieri
Iljazi

(Takohen në paraskenë — Iljazi dhe Sanija.)

ILJAZI — Po hë, moj Sanije. Ç'u bëre?

SANIJA — Ja, sa mora të dhënrat e fundit nga vetë gojët e punëtorëve. Dëgjo. (*Hap një blok*) Që nga e djeshmja, që u muar inisiativa, dhe gjer sot filluan për ngritjen e bibliotekave personale (*numëron*) 20 punonjës, të cilët kanë blerë 200 copë libra.

ILJAZI — Shumë mirë! Fillimi është mjaft i mbarë (*duke i shënuar*). Me këtë inisiativë i ngriti pikat ndërmarrja.

SANIJA — Më vjen keq, shoku kryetar, por ne nuk luftojmë për atë.

ILJAZI — S'luftojmë, po të gjithëve na erdhi mirë atë ditë kur i deleguari në mbledhje tha: Kjo iniciativë është shumë e rëndësishme, duhet bërë shembull në të gjitha ndërmarrjet e tjera. M'u lumi-të! Tani më duhet të shkoj...

SANIJA — Ata po vijnë.

ILJAZI — Kush?

SANIJA — (duke shikuar) Ai në mes është i radios, ai tjetri është i bibliotekës dhe ai më përpalla më duket se punon në gazeten «Pararoja».

ILJAZI — Kanë ardhur për punën e iniciativës (Sanijes) Pregatit!

SANIJA — Për çfarë?

ILJAZI — Për të folur, dhe jepi pa frikë, se, sido që të vijë puna, brenda do jesh! (*Hyjnë të ardhurit*)

TË TRE — Tungjatjetani!

ILJAZI — Tungjatjetani!

BIBLIOTEKARI — Na falni, deshëm të takojmë pak kryetarin e komitetit profesional.

SANIJA — Ja, ky shoku këtu është.

ILJAZI — Ç'dëshëroni?

REDAKTORI I RADIOS — Kemi marrë vesh se në ndërmarrjen tuaj ka lindur një iniciativë për krijimin e bibliotekave personale që meriton vëmendje.

ILJAZI — Jo vetëm ka lindur, po ka filluar të marrë dhe këmbët.

BIBLIOTEKARI — Kaq shpejt?

ILJAZI — Vrulli punëtor shfaqet kudo.

GAZETARI — Mund të na thoni si lindi kjo iniciativë?

ILJAZI — Nga dëshira dhe nga etja e madhe e punëtorëve tanë për librin, shokun e jetës, për

ngritjen e tyre ideologjike e kulturale. Dhe kjo është kaq e vërtetë sa tregon edhe fakti që, qysh dje, mbi 20 punonjës filluan të blejnë libra dhe kanë blerë... (*shikon blokun e shënimeve*).

SANIJA — 200 copë.

ILJAZI — (asaj) U shpejtove, tani mund të jenë bërë 300.

REDAKTORI I RADIOS — Radio Gjirokastra kërkon që për këtë iniciativë të pregetitë një radio-montazh.

ILJAZI — Me gjithë qejf.

BIBLIOTEKARI — Biblioteka mund të ndihmojë punonjësit tuaj për të zgjedhur librat që duhet të pasurojnë raftet e bibliotekave personale.

ILJAZI — Me gjithë qejf. Hajdeni, pse nuk jeni dukur më parë, punëtorët ju presin.

GAZETARI — Gazeta lokale do të shkruajë për këtë një artikull, prandaj dua të bisedoj me punonjësit që kanë filluar ngritjen e bibliotekave.

ILJAZI — Me gjithë qejf. Sanije! Shoqërojeni shokun...

REDAKTORI I RADIOS — Unë dua të filloj incizimin.

ILJAZI — Po s'jam i pregetitur.

REDAKTORI I RADIOS — S'ka gjë, ashtu siç folët pak më parë. (*Ai i zgjat mikrofonin*) Unë do bëj pyetjen, ju do flisni.

ILJAZI — Jam i emocionuar, ndoshta nga entuziazmi, sikur ta ndezim nga një. (*Tjetrit që pret*) Me bibliotekën, siç e sheh, s'bisedojmë dot sot. Mundohuni, hajdeni nesër. (*Largo het i pari. Kalon një punëtor*.) Koço, ç'bëre për iniciativën?

KOÇUA — Dje kam blerë 15 copë libra.

REDAKTORI I RADIOS — Çfarë librash?

KOÇUA — Po, Vëllimin e parë të Veprave të shokut Enver, Kapitalin, dy romane: «Dasmën» dhe «Lumin e Vdekur», 6 broshura, titujt e të cilave, t'ju them të drejtën, s'i mbaj mend të gjithë.

REDAKTORI I RADIOS — Keni bërë plan për leximin dhe për shfrytëzimin e tyre?

ILJAZI — (e ndërpret) Posi, patjetër!

KOÇUA — Tri herë në javë, në orët që ndiqja shkollën e mbrëmjes, të cilën e mbarova. (*Hyn portieri*).

PORTRIERI — Më falni, se mos keni edhe ndonjë fjalë, po... (*u jep një copë letër*) Më shkruani këtu emrat e librave më të reja që kanë dalë.

GAZETARI — Ja, po t'i shkruaj unë, xhaxha, apo lexon vetë ti?

PORTRIERI — Gazetën thembër më thembër çdo ditë, ca libra që flasin për luftën dhe tani po lexoj: «Se trimat ashtu e kanë». (*Ndërsa tjetri shkruan*) Pak shpejt, se më pret vajza, t'ja jap të m'i marrë.

REDAKTORI I RADIOS — (*duke ja dhënë*) Urdhëro!

PORTRIERI — Falemnderit (*Ikën*).

ILJAZI — Besoj se do të duhen edhe punëtorë të tjerë për të folur?

REDAKTORI I RADIOS — Jo, se Koçon e xhaxhanë e inçizova.

ILJAZI — Atëherë shkojmë. Sa i emocionuar që jam, mos më doli zëri sikur ka shkarkime atmosferike? (*Qesh*)

REDAKTORI I RADIOS — Mos ki merak.

(*Pas një muaji*)

KOÇUA — Shoku kryetar, kemi disa punonjës që akoma nuk e vënë ujet në zjarr pér punën e bibliotekave. Sikur tē bënim një mbledhje?

ILJAZI — Do ta vënë ujet në zjarr ata edhe pa mbledhje, po lerna se kemi halle tē tjera tani. S'na lënë zilet tē dëgjojmë dhe këmborë!

KOÇUA — Tē paktën tē bënim ndonjë reçension pér ndonjë libër tē ri.

ILJAZI — O po, s'kemi c'bëjmë më, u bë c'u bë, namin e muarëm ne tani. Mendon dot ndonjë inisiativë tjetër?

KOÇUA — Inisiativë tjetër! Duhet tē çojmë këtë gjer në fund, pastaj, Tē mos e bëjmë si flakë kashte.

ILJAZI — Ohu, ty tē ka vdekur mendja, je me oreks sot. (*Ikën*)

(*Pas gjashtë muajsh.*)

GAZETARI — Shoku Iljaz, besoj se tani do keni rezultate akoma më tē mëdha pér gazeten?

ILJAZI — Sa tē duash, folë, pérse interesohe ni?

GAZETARI — Pér inisiativën e ngritjes së bibliotekave personale nga punonjësit.

ILJAZI — Ç'është kjo inisiativë? Tani e marr vesh!

GAZETARI — Si ore, tani e mirrni vesh, para gjashtë muajsh ju e kishit marrë me aq zjarr!

ILJAZI — Nuk e di. Mos ju kanë drejtuar pér në ndonjë ndërmarrje tjetër dhe më kini ngatërruar; (*me tē qeshur*) pa shiko, fresko kujtesën.

GAZETARI — Ju thonë juve Iljaz, punoni në këtë ndërmarrje? (*I tregon gazetën*) Ja dhe artikulli që kam shkruar atëherë.

ILJAZI — (*pasi e lexon*) Çudi, të kemi marië ne iniciativë të tillë!.. (*Ndërsa ai po mendohet, korrrespondenti ikën. Iljazi Kujton se është aty*) A a... Po... Mor po dhe këta vijnë në një kohë kur jemi zhvidhosur fare!

S'KE Ç'BËN ME MASËN

PERSONAZHET:

Kryetari	Lipja
Miçua	Agroni
Kiçua	Fiqiriu
Refati.	

(*Hyjnë: Kryetari i komitetit profesional me një dosje, pas tij punonjës të tjerë që zënë vend nëpër karrige. Jemi në mbledhje*)

KRYETARI — Uluni!.. Shokë, organizojmë këtë mbledhje të shkurtër për të ndarë disa detyra, për të mos e monopolizuar punën, për të bërë që ajo të shkojë sahat. Në radhë të parë duhet të caktohet një nga shokët ose shoqet mësuese për të zhvilluar në brigadën e pestë disa biseda shkencore (*Zhurmë*)

KIÇUA — Me lejë?... Unë mendoj se këtë punë mund ta kryejë më së miri shoku Lipe, i cili ka një përvojë të pasur, është i gojës, me njoħuri dhe me horizont të gjerë kultural dhe ka fituar një simpati të madhe te kooperativistët, që mund të them, me plot gojën, pa frikë, se e duan si djalin e tyre.

TË GJITHË — Aprovohet.

LIPJA — Më falni një minutë. Unë s'kam as tre muaj që kam ardhur në këtë fshat dhe...

ATA — Léri justifikimet, ulu!

KRYETARI — Qetësi!.. Vazhdojmë më poshtë. Na duhet që me nxënësit të sistemojmë kopshtin e shkollës. Për këtë duhet caktuar një shok që të udhëheqë punimet.

KIÇUA — Me leje?.. Në qoftë se duam që puna të shkojë sahat dhe të mbarojë shpejt, të caktojmë Lipen, i cili është i papërtuar, që, kur ngulet në punë, harron të hajë edhe bukë, që punon sa për shtatë, që është një buldozer i vërtetë. (Zhurmë)

MIÇUA — Aprovohet.

LIPJA — Me leje, desha të thoshja që s'janë të vërteta.

KIÇUA — Mos ju shmang punës.

MIÇUA — Ulu!

KRYETARI — Shoku Lipe, po ta besojmë ty dhe të urojmë suksese.

LIPJA — (i mërzitur) Të falem nderit. (Zhurmë)

KRYETARI — (pa përfillur protestat vazhdon) Siç jeni vënë në dijeni, gjer më datën 20 të këtij muaji duhet të mbarojë lyerja e shkollës brenda dhe jashtë, për këtë...

MIÇUA — (ngrihet me vrull dhe e ndërpert) Shokë, mos ju duket si çudi që do të përmend emrin e Lipes, i cili është i gjithanshëm dhe për këtë bravo i qoftë. Lipja, shokë, është njeri me merak, ka shije për kombinimin e ngjyrave dhe këtë e vërteton më së miri veshja e tij: kombinimi i këmishës, i gravatës, i xhaketës, kujdesi për flokët e

bëjnë Lipen të duket si djalë 15-vjeçar plot frëski.
Lipja ka sy të mprehtë, ka... e ç'nuq ka tjetër.

KIÇUA — Aprovohet.

LIPJA — Dale, more shokë!

MIÇUA — Mos u shmang.

KIÇUA — Luftë indiferentizmit!

TË DY — Ulu!

REFATI — Prisni, more shokë, do të pyetemi edhe ne apo jo?

KRYETARI — (*bën sikur nuk dëgjon*) Që nesër, Lipe, fillo organizimin e punës... Tani na duhet që, së bashku me rininë e fshatit, të pregetitim një shfaqje estrade; kush nga ne mësuesit duhet të marrë pjesë në grupin e estradës?

KIÇUA — (*ngrihet duke mos përfillur të tjerët*) Erdhi rasti dhe do ta them. Shokë dhe shoqe! Midis nesh ndodhet një aktor i mrekullueshëm, i cili me vështrimin e parë të bën të vdesësh gazit, që kur del në skenë korr duartrokositje pa folur fare, që ka një mimikë plastike dhe diksion të pastër. Cili është ky shok do të thoni?.. Ky është shoku Lipe Molla.

LIPJA — (*i revoltuar*) Po mua më merret goja!

MIÇUA — Ulu!.. U vendos.

LIPJA — Ç'bëni kështu, more shokë.

KIÇUA — S'ke ç'bën me masën.

LIPJA — S'ke ç'bën kur të vënë në shenjë!

KRYETARI — (*duke u larguar*) Me kaq mbledhja mbaroi.

REFATI — Pritni, shoku kryetar. Mbledhja nuk mbaroi, por më duket se tani filloi.

KRYETARI — (*kthehet*) Kush foli kështu?

TË TJERËT — Ne, kolektivi.

18463

KRYETARI — U zgjuat nga gjumi? Hë, ç'keni pér tē folur?

AGRONI — Kjo mbledhje duhet anulluar se pse është formale, qesharake dhe ne e dënojmë.

KRYETARI — Pse?

FIQIRIU — Se ju e bëtë këtë sa pér tē kaluar radhën, pa u thelluar në problemet.

REFATI — Ju, shoku kryetar, përkëdhelni indiferentizmin, përkëdhelni shokët Kiço e Miço që i mbajnë iso indiferentizmit tuaj.

KRYETARI — Nuk lejoj tē flitni në këtë mënyrë!

TË TRE — Është masa që vendos dhe gjykon.

KIÇO—MIÇO— (të frikshëm) Hej, ç'dreq na polli!

LIPJA — (pasi i dëgjon) Nuk bëhet Lipja top futbolli!

KUNGULLESHKAT E ANËTARËVE TË KOMITETIT PROFESIONAL

PERSONAZHET:

Bilbili
Xhaferi
Lazja
Nikua
Leta.

*(Në rrugë, Bilbili po shtyn një rrotë magine.
Përpara i del Leta)*

LETA — Shoku Bilbil, vij të flas edhe unë në emër të punonjësve të tjerë të repartit. Ju, si kryetar i komitetit profesional të ndërmarrjes, që kur jeni zgjedhur, s'keni bërë asnjë mbedhje me punonjësit, pastaj kuotat shkuan kaq muaj pa u mbledhur. Cili nga anëtarët e komitetit interesohet përkëtë problem?

BILBILI — (*i menduar*) Për kuotat është ngarkuar, është ngarkuar.... Xhaferi. Po ç't'i bësh kur s'kryen detyrën; e kanë si angari. Po s'përtove foli pak.

LETA — Xhaferit? Posi! (Del)

BILBILI — (vetëm) Mirë më kujtoi kjo, duhet bërë një mbledhje me anëtarët e komitetit t'i shkund një herë, se ka bërë fole merimanga mbi ta. (Hyn Leta me Xhaferin)

XHAFERI — Më thirrët, shoku Bilbil?

BILBILI — Të thirra, more Xhafer. Ti, si anëtar i komitetit profesional, je ngarkuar për financën.

XHAFERI — C'thuas, more shoku Bilbil, unë s'jam fare anëtar i komitetit, vjet isha, por më shkarkuan.

BILBILI — Je.

XHAFERI — S'jam.

BILBILI — Po kush është?

XHAFERI — Kur s'e di ti si kryetar, nga do ta di unë.

LETA — (Bilbilit) Si bëhet?

BILBILI — (pasi mendohet) Do jetë Lazja. (Xhaferit) Foli pak të lutem. (Mbasi largohet Xhaferi me Letën) Po sikur të mos jetë as ky, kush do të jetë pastaj?! (Hyn Lazja)

LAZJA — Më kërkuaat?

BILBILI — More Laze, je anëtar i Komitetit profesional?

LAZJA — Unë anëtar i komitetit profesional!? Mos e thuaj prapë këtë, se të mori historia.

BILBILI — Domethënë e mban mend mirë që s'je.

LAZJA — Unë mbaj mend përmendësh gjithë shekullin XVIII, XIX, dhe XX në histori, e jo atë që më tha ti.

BILBILI — (Xhaferit) Xhafer, më fal, po do të bësh dhe një mundim, foli pak Nikos. (Me vete)

Këtë nuk e pyes je apo s'je, por do t'ja bëj fakt të kryer, se pérndryshe të shkasin këta. (*Hyn Nikua*)

NIKUA — Ç'më deshët, shoku Bilbil?

BILBILI — Ti Niko, si anëtar i komitetit profesional që je...

NIKUA — (e ndërpret) Kush më caktoi?

BILBILI — Mbledhja e organizatës profesionale.

NIKUA — Ç'më bëre pér të qeshur. Unë s'jam zgjedhur kurrë më lart se në postin e mbajtësit të procesverbalit nëpër mbledhje.

BILBILI — Xhafer!

XHAFERI — Mos doni të thërras gjithë punonjësit një nga një?

(*Hyn Leta*)

LETA — E, shoku Bilbil, cilët janë anëtarët?

BILBILI — Hall i madh (*duke futur dorën në chep*) Pa të hap një herë listën. (*Hap portofolin*) Më duket se e kam këtu. (*Nxjerr një letër të çetterë ku nuk kuptohet asgjë*) Ja, kjo është, po s'duket gjë, se janë shuar të gjithë.

LETA — Si duhet të bëjmë atëherë?

BILBILI — Unë them që është Lazja.

LAZJA — Pse të jem unë?

BILBILI — Po kush?

LAZJA — Nikua!

NIKUA — Pse të jetë Nikua?

LAZJA — Po kush?

NIKUA — Të jetë Xhaferi!

XHAFERI — Pse të jetë Xhaferi?

NIKUA — Po kush?

XHAFERI — Të jetë Bilbili!

LETA — (ndërpret) Kungulleshkat luani? Pse nuk tregoheni të sinqertë?.. Ja, po jua them unë.

NIKUA — Unë e mbaj mënd mirë që Lazja
është zgjedhur.

LETA — Po, si anëtarë të komitetit janë: Shok
ku Laze.

LAZJA — Jam unë?!

NIKUA — Shoku Laze, mos bëj naze!

BILBILI — (Lazes) Dil këtej.

LAZJA — Në daç andej, në daç këtej prapë
Laze jam unë.

KRYETARI — Laze, Laze po na hap avaze.

LETA — Dhe këtë avaz do ta dëgjoni më mirë
në mbledhjen e organizatës profesionale.

U NGEICI SHARRA NË GOZHDE

PERSONAZHET:

Mihallaqi	Veliu
Sotiraqi	Shefi
Spirua	Kooperativisti

(Mihallaqi dhe Sotiraqi duke hyrë në zyrë.)

MIHALLAQI — Kështu, o Sotiraq, u mbushën dy vjet që ke ikur në fshat.

SOTIRAQI — Dy vjet, një muaj, pesë ditë e gjashtë orë.

MIHALLAQI — (*i mallëngjyer*) Më kujtohet ajo ditë që u ndamë, pa-pa-pa, sa prekësse ka qenë. Ti flisje në mbledhje, mua vu lotët; të betohem as bukë s'kam ngrënë atë darkë. E di si më është dukur! Që kur më ike nga zyra, sikur diçka më munconte.

SOTIRAQI — Pa pyetëm mua, muaj më është dukur ora, e kuption? Me kë të rrish, me kë të bisedosh, lëre, lëre, mblidhe në shtëpi që kur perëndon dhe bisedon me vete. U tmerrova, po lërmë të çmallem. (*I afrohet maqinës së shkrimit*) Oh, ma-

qina e shkrimit, ja dhe karriga ime... Pesë minuta në vendin tim. (*Merr poza me receptorin e telefonit në dorë*)

MIHALLAQI — Ke të drejtë. Ti rri atje tani dhe mua më kujtohet kur më thoshje: ngrihem i të pimë nga një kafe?

SOTIRAQI — (që s'e ka mendjen) Ngrihem.

MIHALLAQI — Them për atëherë! Ngrihem i të kthejmë nga një gotë, ngrihem! Kur na hipte në kokë për një gjë s'kish burrë të na ndalonte. Edhe kur na mbyllnin derën dilnin nga dritarja.

SOTIRAQI — Ç'e do, shkuan e vanë.

MIHALLAQI — Mos u mërzit, do të të sjellim përsëri.

SOTIRAQI — S'më besohet. Po më thuaj tani, sa jemi dhe vetëm, ç'u bë për sa kemi biseduar, a i shtyve ndonjë çikë urët?

MIHALLAQI — Sot janë vënë të gjithë në lëvizje, Spirua, Veliu, është ndërhyrja vendimtare, ose merr fund sot, ose askurrë, ose do të të bie ty këtu, o erdha dhe vetë atje.

SOTIRAQI — Po hë, si?

MIHALLAQI — Dy shtigje i kam çarë, tani vetëm shefi i ri të shohim çdo të na bëjë.

SOTIRAQI — Ja ke thënë?

MIHALLAQI — Ja thashë një ditë dhe ma pruri një çikë si rrrotull. Kam besim se s'do të ma prishë, se, nga një mblesëri që u bë kohët e fundit, u bëmë dhe tanët. Është njeri i mrekullueshëm. Sa i pëlqejnë njerëzit kompetentë, specialistë, shakaxhinj dhe me kulturë! Do ta shikosh, kur të vijë.

SOTIRAQI — Më vjen si zor.

MIHALLAQI — Budalla, është rasti më i mirë për t'u prezantuar. Me këtë rast lësho edhe ndonjë

arësyetim prej kompetenti që të vërtetosh thënjet e mia.

SOTIRAQI — Po Veliu kujt do t'i thotë?

MIHALLAQI — Veliu do të futë teton.

SOTIRAQI — Ta mbarojë dot tetua, thua?

MIHALLAQI — Tetua? E njeh? Turjelë, trapano sëhtë fare. Të hyn nga deriçka ajo pa e kup-tuar.

SOTIRAQI — (*gazmor*) Aman ore! Po erdha, s'di se ç'do të bëj nga gëzimi. (*Ngrihet e përqafon*)

MIHALLAQI — (*ndërpret të qeshurën*) Po vjen shefi.

SOTIRAQI — Ku e di ti?

MIHALLAQI — E njoh nga këmbët. (*Hyn Shefi*)

SHEFI — Hë, Mihallaq, e lajmërove NTSH-AP-in në telefon?

MIHALLAQI — (*servil*) Do të më falni, shoku shef, se sa u nisa për të shkuar, më erdhi shoku i vjetër i zyrës dhe...

SHEFI — Ashtu... (*Sotiraqit*) Ju jeni...

SOTIRAQI — Sotiraq Fitili.

SHEFI — Më ka folur Mihallaqi për ju (*Mihallaqi ja bën me shenjë Sotiraqit*) Llogaritar në koo-perativë jeni?

SOTIRAQI — Si urdhëron.

SHEFI — Si ju duket fshati?

SOTIRAQI — Mirë, po ka dhe më mirë.

SHEFI — (*që në fillim s'kupton*) Si duket ka edhe më përparrë.

SOTIRAQI — Ka, po të të hapin rrugën.

SHEFI — Pse, kush ua ka mbyllur?

SOTIRAQI — Ata që na e kanë mbyllur ikën, po edhe këta që erdhën s'na e hapin.

SHEFI — I kritikoni, luftoni bashkë me koo-perativistët të ndryshoni gjendjen.

SOTIRAQI — S'të ndihmon njeri. Unë vetëm kam mbetur në gjithë krahinën.

SHEFI — Pse, ku janë të tjerët?

SOTIRAQI — Erdhën të gjithë këtu.

SHEFI — (*shikon me habi nga Mihallaqi*) Për se e kini fjalën ju? Më duket se u keqkuptuam, apo jo Mihallaq?

MIHALLAQI — (*me buzëqeshje*) Ka lidhje me bisedën e djeshme... Ua them pastaj. (*Bie zilja e telefonit. Shefi ngre receptorin*)

SHEFI — Urdhëro, po, këtu është... (*Atyre*) Dikush interesohet për shokun Sotiraq dhe më tha se do të vijë në orën njëmbëdhjetë.

SOTIRAQI — (*Mihallaqit*) Do të jetë Spirua.

MIHALLAQI — (*shefit*) E kërkojnë të gjithë sa herë që vjen në qytet, ka shkuar mirë me të gjithë.

SHEFI — Po në fshat ç'hotë shoqëria?

SOTIRAQI — As qan, as qesh, as vete, as vjen; se po u trazove është si puna e valles që thonë: Jep pesë lekë e hyn në valle e jep njëqind e s'del dot pastaj.

SHEFI — Po pse kështu?

SOTIRAQI — Se, po t'u hysh në zemër, s'të lëshojnë më, mbetesh pilaf atje.

SHEFI — Më duket se këtu nuk keni të drejtë.

MIHALLAQI — (*ndërhyr*) Ky është dhe i së-murë, shoku shef, me raport. Vuan nga tensioni dhe nga mëlcia e zezë. (*Bie përsëri telefoni*)

SHEFI — Urdhëro... Po, këtu është edhe shoku i tij... Mirë. (*Atyre*) Një shok i juaj, në orën njëmbëdhjetë do të vijë këtu, thotë.

SOTIRAQI — Na falni, se ndoshta keni dhe punë dhe ju bezdisëm.

SHEFI — S'ka gjë, rrini... Po në lidhje me të kaluarën, besoj se do të ketë bërë ndryshimë të mëdha fshati.

SOTIRAQI — Pse t'ju gënjej, nuk di gjë. Unë dy vjet kam që jetoj atje.

SHEFI — Si kështu, po të paktën në ndonjë bisedë që ke bërë me pleqtë mbrëmjeve.

SOTIRAQI — A, unë nuk rri mbrëmjeve atje, familjen e kam këtu.

SHEFI — Ashtu thuaj, domethënë je me një këmbë në qytet dhe me tjetrën në fshat.

MIHALLAQI — Ç'të bëjë, shoku shef, e shkundi urbani, gjysmën e rrogës nëpër maqinë e lë.

SHEFI — Po atë që ke në fshat e ke ngulur mirë, apo jo?

SOTIRAQI — T'u them të drjetën, në hava e mbaj, mjafton të jepet...

SHEFI — Kush?

MIHALLAQI — Sinjali. (*Bie zilja e telefonit*)

SHEFI — (*duke folur në telefon*) Po, këtu është. Jeni Prokopi? S'vini dot në orën njëmbëdhjetë? Po, t'i thotë Sotiraqit vajzë?

SOTIRAQI — Ëhë, s'na bëri gjë Prokua. Kishim shumë shpresa.

MIHALAQI — Mos u dekurajo.

SHEFI — Ju ka bërë gruaja vajzë dhe mërziteni?

SOTIRAQI — More, ta kish bërë gruaja s'do thoshja gjysmë fjale, po ma bëri Prokua. (*Shefi shikon nga Mihallaqi*)

MIHALLAQI — (*i shpjegon*) Kur ndonjë njeri

s'na mbaron punën që i kemi ngarkuar, ka mbetur që themi vajzë!

SHEFI — Në vend që t'i hiqni nga fjalori këto fjalë që poshterojnë personalitetin e gruas, ju... (*Hyn një kooperativist, i cili, sa shikon Sotiraqin, i derdhet*)

KOOPERATIVISTI — Po këtu je, more shoku Sotiraq, po s'kam lënë vend pa të kërkuar, more byrazer, po më ranë këmbët poshtë e lart. Një herë të gjej atje, një herë aty e një herë këtu, mbete zyrave të qytetit, s'e rregullove akoma për të ardhur? (*Atyre*) Merreni fare, more shokë, se s'na bën kjo plaçkë ne.

SOTIRAQI — Mjaft me revoltime, çfarë kishe?

KOOPERATIVISTI — Na, firmose, se mbylllet banka; pa ti, ohu — he! (*Ndërsa ai largohet e shefi diçka shkruan, hyjnë njëri pas tjetrit Veliu dhe Spirua duke përshëndetur*)

MIHALLAQI — Këtej (*I mbledh në tavolinën e tij dhe bisedojnë me zë të ulët kokë më kokë*)

SPIRUA — Kam që në mëngjez që s'kam vajtur fare në zyrë sot, më ranë këmbët, më në fund e gjeta, ishte dhe në orë të mirë, i fola, më foli, i buzëqesha më buzëqeshi. Më pyeti e pyeta.

SOTIRAQI — Po hë, mos e zgjat, vajzë apo djalë?

SPIRUA — (*pas një pauze*) Hëpërhcë vajzë. (*Sotiraqi zë fytyrën me duar*)

MIHALLAQI — Po tetua ç'bëri?

VELIU — Tetua ja tha copë dhe, në krahun e saj cau me guximi përpara.

MIHALLAQI — Thashë unë, turjelë është ajo.

VELIU — Po...

SOTIRAQI — Çë, vajzë?

VELIU — Jo, djalë. Pér ty moj teto, i kish thënë, do të bëj qindin... Por, i kish thënë, fjalën e fundit e ka ky (*tregon shefin*)

SPIRUA — Nuk ja themi një herë të gjithë, jemi që jemi. Tre me një do ta mundim, sikur edhe në tank të jetë futur.

MIHALLAQI — Mirë e mendove. Unë e hap, Veliu e fillon, dhe Spirua e mbaron. Ti, Sotiraq, dil përjashta tani dhe hyrë më vonë. (*Sotiraqi del*) Shoku shef...

SHEFI — Hë more, ç'kini kështu?

MIHALLAQI — (*servil*) Kërkojmë brenda mundësive të na mbarosh një hall.

SHEFI — Po të mundem pse jo — hë? (*Mihallaqi i bën shenjë Veliut*)

VELIU — Sotiraqi, shoku Andon, e njihni Sotiraqin? Specialist i mbaruar, na mbeti në fshat, sikur ta...

SHEFI — Si ta? (*Veliu i jep shenjë Spiros*)

VELIU — Ja, ta thotë Spirua.

SHEFI — Hë, more Spiro!

SPIRUA — (*me ndrojtje*) Nuk e di në do na e mbarosh... Ja, ta thotë Mihallaqi.

MIHALLAQI — Ta thotë Veliu më mirë.

VELIU — Jepi Spiro, se topin ta vura në pikën e penalltisë, mos u dridh ta gjuash!

SHEFI — Hë de, folni, ç'far doni t'ju mbaroj?

MIHALAQI DHE VELIU — Gjuaj Spiro!

SPIRUA — Të na bini Sotiraqin përsëri këtu, sepse është i nevojshëm, puna e tij nuk zëvendësohet. Ka dy vjet që u telendis dhe na telendisi.

MIHALAQI — Mos na e prish!

VELIU — Do t'ju jemi mirënjojës.

SHEFI — (*duke u ngritur në këmbë*) Turp të

kini! Mirrni nën sqetulla njerëz që janë dërguar me detyrë në fshatrat e prapambetura, ndërsa ju iu prishni mendjen, iu hiqni interesin për punë, në vend që të bëni të kundërtën. Përpinqeni t'u siguroni qoshe të rehatshme. (*Të gjithë kanë ulur kokën e kanë mbetur si të ngrirë. Hyn Sotiraqi*)

SOTIRAQI — (që i shikon ushtu si të ngrirë)
Folni de, e tundi rrjetën Spirua?

ATA — Jashtë.

SOTIRAQI — (duke u larguar) Po as penalltinë nuk e bëre dot gol, more Spiro?

FAMILJA DISKUTON

PERSONAZHET:

Burri
Gruaja
Petriti
Gimi.

.....

BURRI — (*duke hyrë i jep gruas një letër*)
Urdhëro grua!

GRUAJA — Ç'është kjo?

BURRI — Letër nga drejtoria e shkollës. Bëhet mbledhje e prindërve pér të dhënë edhe nemendime rrëth mësimit, librave e çështjeve të tjera, që kanë të bëjnë me edukimin e fëmijëve.

GRUAJA — Shumë mirë.

BURRI — Shumë mirë, shumë mirë, po mbi se do të diskutojmë?

GRUAJA — Mbi ato që thotë gazeta çdo ditë.

BURRI — Pa fillo një herë ti, shoqja grua, të dëgjoj edhe unë.

GRUAJA — Petriti ynë është në klasën c parë?

BURRI — Po.

GRUAJA — Abetarja ku mëson Petriti ynë edukon me fryshtë e kohës?

BURRI — Po, Petritin tonë mirë e ka edukuar, moj grua, e ke dëgjuar ndonjëherë të kundërshto-jë, të nxjerrë ndonjë fjalë të keqe nga goja? Të mblidhet në shtëpi që me pulat. Ta di abetaren përmendësh.

GRUAJA — Jo vetëm për sjelljen, po për konceptet, për mbeturinat mikroborgjeze.

BURRI — Mbeturinat nuk i lë njeri të merren me Petritin tonë.

GRUAJA — Nuk i lë ti, po i lë abetarja.

BURRI — S'është e mundur!

GRUAJA — Ta provojmë. (*I flet Petritit*) Petrit! (*Dëgjohet zëri i tij*) Hajde të keqen nëna këtej dhe merr edhe abetaren me vete. (*Burri*). Tani do ta shikosh, dëgjo dhe mbaj shënim të diskutosh. (*Hyn Petriti dhe i afrohet babait*) Hape abetaren te «N-ja» Petrit!

PETRITI — (*lexon*) N, n e vogël e shtypit. N e madhe e shtypit, në-na.

GRUAJA — Ç'bën nëna aty, Petrit?

PETRITI — Qindis.

GRUAJA — (*i afrohet*) Po këtu, ç'bën nëna?

PETRITI — Lan rrobat.

GRUAJA — Po këtu?

PETRITI — Hekuros.

GRUAJA — Po këtu, ç'bën babai?

PETRITI — Babai lexon gazetën, nëna qëron patatet.

BURRI — Ç'kupton nga kjo ti, Petrit?

PETRITI — Nëna punon, babai bën qejf.

GRUAJA — Pse s'punon dhe babai, Petrit?

PETRITI — Babi punon vetëm në zyrë, nëna edhe në shtëpi.

GRUAJA — (burrit) E shikon, more burrë?!

BURRI — Po kur të bëhesh burrë ti, Petrit, këtij babit këtu do t'i ngjasësh, apo...

GRUAJA — Si mami!

BURRI — Si babi!

PETRITI — Të shohim, si të më thotë mendja.

BURRI — Të keqen e mendjes. Të bëhesh si babi, more Petrit, që psonis, që lan enët, pjatat, që bën edhe gjellë.

PETRITI — Unë në abetare nuk kam parë ndonjë babi që të lajë edhe pjatat e të bëjë gjellë.

BURRI — Do të shikosh... Ja, shiko babin tënd ti.

PETRITI — Po ti, babi, vetëm vezë di të bësh.

BURRI — Po vazhdove kështu ti, kur të bëhesh si unë, as vezë s'do të bësh dot.

GRUAJA — Mbaj shënim burrë, emancipimi në abetare.

BURRI — (hap një faqe tjetër) Po këtu, Petrit, ç'është shkruar?

PETRITI — (duke lexuar) Kopshti im.

GRUAJA — Prona private në abetare, burrë, shëno!

BURRI — Ku e ke kopshtin ti, Petrit?

PETRITI — Unë s'kam, ky është kopshti i Agimit.

GRUAJA — Ç'e duam kopshtin ne, Petrit, mollët, domatet i marrim në dyqan.

PETRITI — Po ato i blejmë me lekë, moj mami.

BURRI — Mos e zgjat grua, nesër mbrëma fi-

llo leksionin e parë me djalin e vogël mbi pronën private.

PETRITI — Ç'është leksioni, babi, film?

BURRI — Nesër mbrëma do ta marrësh vesh; po shko tani dhe foli Gimit. (*Gruas*) Çatia e abetares, grua, qenka fare pa patavra. (*Hyn Gimi*) Hë, Gimi, ç'mësoje ti?

GIMI — Historinë, babi, kemi piramidet e faraonëve të Egjiptit.

GRUAJA — C'janë këto piramide, more bir?

GIMI — Varret e mbretërve, mama.

BURRI — Mirë, mirë, vazhdo!

GIMI — Më ngatërruat, do ta filloj nga e para... Në shkretëtirë janë ngritur piramide që flasin për lashtësinë dhe për shfrytëzimin e atë-hershëm të sklllevërve.

BURRI — Po sot ka shfrytëzim atje, more bir?

GIMI — Libri s'thotë gjë.

BURRI — C'qeveri ka sot Egjipti?

GIMI — S'e di... T'ja fut nga mendja?

BURRI — Vazhdo, bir, vazhdo me piramidet ti.

GIMI — Piramida më e madhe është ajo e Keopsit që është 127... jo 130 metra e gjatë.

BURRI — (*nervoz*) Jo, 170 metra e gjatë.

GIMI — Nga e di ti, babi?

BURRI — Thuaje more, se s'na prishet puna për Keopsin e Egjiptit.

GIMI — Po të gabosh në gjatësinë e në gjerësinë e pyramidës të ul një notë profesori.

BURRI — Ua! Mirë, vazhdo, djalë!

GIMI — Për të ndërtuar këtë pyramidë u deshën 30 vjet, 10 vjet u deshën vetëm për të grumbulluar gurët që ishin sa një shpellë.

BURRI — E vogël, apo e madhe?

GIMI — Ku di unë, sa një shpellë thotë atje, pastaj kjo piramide ndryshon nga ajo e faraonëve të tjerë, se... dale se e harrova.

BURRI — Këto shpellat e piramidës së Keopsit edhe mua ma turbulluan mendjen, mëre djalë.

GRUAJA — (*duke hyrë*) Mos e mëso përmendësh, Agim, se nesër do ta harrosh prapë... prandaj...

GIMI — Punë e madhe... t'ja them një herë mirë mësuesit unë, sa të marr notën, pa ç'do më duhen mua nesër shpellat e faraonëve të Egjiptit!

GRUAJA — E shikon, burrë?

BURRI — (*duke shkruar*) Mirë më armatose, mëre bir, për nesër mbrëma. Nja tre ballë me fyshekë më ke dhënë.

GIMI — Me kë do luftosh, babi?

BURRI — Me firaunët e Egjiptit.

DIALOG NË DRITARE

PERSONAZHET:

Feneri	Llamba elektrike
Llamba	Sportelistja
Fotia	

(*Në dy dritare, përballë njëra-tjetrës, duket feneri dhe llamba*)

FENERI — Llambë, moj, ti je?!

LLAMBA — Unë jam, nuk më sheh?

FENERI — Po pse ke dalë në penxhere?

LLAMBA — Nuk e shikon ç'po bëhet? Ngrejnë shtyllat edhe këtu për të vënë dritën elektrike.

FENERI — E shikoj, ato janë trikëmbëshat tanë. Më dridhet vixhuti sikur më ka zënë korrenti.

LLAMBA — Si do bëjmë, na erdhi fundi! Ke dëgjuar ndonjë fjalë nga të zotët e shtëpisë ti?

FENERI — Mbrëmë, Zoica mezi më ndezi dhe zuri të më mallëkonte: «Hë, more, u shkretosh! Ndizu edhe sonte, pa nesër mbrëma ma merr të keqen, do të të futim në rangullina!»

LLAMBA — Mua ma hoqën qelqin që sot dhe më mbajtën në dorë si foti. Ç'do na shohin sytë, thuaj, nëpër qilare!

FENERI — Unë kam 15 ditë pa u fshirë, shih si dukem, sikur vij nga depua e qymyrit.

LLAMBA — Mallëkuar qoftë ai që shpiku elektrikun!

FENERI — Moj, po dale, pa do të na kujtojnë ndonjëherë, kur t'i zërë elektriku. Ku je, fener, do të thonë!

LLAMBA — Shëët! (*Diku shikon*) Uaa! Ç'është ajo që u rrokullis në përrua?

FENERI — Fotia.

LLAMBA — Bobo, e shkreta! Ja bënë kokën xhumba-xhumba (*hyn Fotia duke qarë*)

FOTIA — Ua, ç'më gjeti, bishti në përrua më mbeti.

TË DY — Foti!

FOTIA — Ku jeni, moj motra?

TË DY — Këtuuuu!

FOTIA — Hajde, moj, të mblidhem i kokë më kokë, të qajmë hallin dhe të ikim nga ky fshat. Nuk e shikoni korrentin që do të na zëri të gjallë?!

TË DY — Mirë thotë.

LLAMBA — Ikim në një fshat tjetër (*U del përpara llamba elektrike me një shkëlqim që verbon*)

LLAMBA ELEKTRIKE — Ndal!.. Duart lart! Jeni të rrethuar.

FENERI — Hapna rrugën; ne s'ngasim njeri. Ç'keni me ne tanë që po japim shpirt. Lërnani, do të shkojmë në fshatin tjetër.

LLAMBA ELEKTRIKE — Edhe atje shkoi dje drita elektrike.

ATO — Uaa!...

FENERI — Vemi më tutje. Ku ka vend?

LLAMBA ELEKTRIKE — Pyetni sportelis-tin!

ATO — (*afrohen te sporteli në anën e skenës*)

Ka ndonjë vend për ne?

SPORTELISTJA — Jo, s'futim të tilla pisllëqe në hotel.

ATO — Aman, moj mike!

SPORTELISTJA — I zuri llamba elektriqe.

ATO — (*duke u larguar*) Oh, ç'do mbetemi pa strehim!

FENERI — (*duke ecur*) Bllum, bllum!

ATO — Për ku?

FENERI — Në muzeum. (*Largohen*)

VRAVA TË NESËRMEN

PERSONAZHET:

Punëtori
Sabriu
Kamberi
Brahua

PUNËTORI — Shoku Sabri, si u bë puna e atij racionalizimit tim?

SABRIU — (*pak i hutuar*) Oh, sa mirë që më kujtovë! (*Niset nga erdhi*)

PUNËTORI — Po hë de, se vate gjashtë muaj.

SABRIU — (*kthehet përsëri*) Ah, jo, i kam në çantë.

PUNËTORI — (*hutohet*) Cilat?

SABRIU — Referatin për shpikje dhe racionalisime; ç'do të thoshja në mbledhje thuaj!... (Atij)
U mblohdhën?

PUNËTORI — Kush, more shoku Sabri?

SABRIU — Oh, harrova që s'e kam mbledhjen me ju. (*Ikën dhe kthehet prapë*) Ç'kishit ju, se harrova?

PUNĒTORI — (*nervoz*) Përgjigjen për racionalizimin tim.

SABRIU — Mos më ngatérro. Tani kam punë urgjente. Hajde nesér në zyrë!

PUNĒTORI — Po ka një muaj të téré që më thua: «Eja nesér, eja nesér!» (*Ndërsa ai ka ikur, në drejtim të punëtorit vjen një tjetër*) Shoku Kamber, çatia e apartamentit tonë éshtë bërë shoshë, kur do ta dërgoni ustanë ta rregullojë?

KAMBERI — Bëni një lutje!

PUNĒTORI — Kam bërë tri gjer tani dhe...

KAMBERI — (*duke ikur e ndërpret*) Hajde nesér ta marrësh përgjigjen!

PUNĒTORI — (*Takon një të tretë*) Shoku Braho, pse s'na flet?

BRAHUA — Hajde nesér!

PUNĒTORI — Ua!.. Po përse?

BRAHUA — Të thashë, hajde nesér!

PUNĒTORI — (*nxjerr një pistoletë starti dhe shtie. Brahuva dhe Kamberi afrohen të alarmuar*)

BRAHUA — Ç'është, ç'bëre kështu?

KAMBERI — Kë goditët, kë vratë?

PUNĒTORI — Vrava të nesërmen.

ATA — Pse?

PUNĒTORI — Që ju të mos thoni më: «Hajde nesér»!

KEMI KOHË

PERSONAZHET:

Aliu

Zylyfi

ALIU — Zylyf, sot shko të marrësh fuçitë që kanë mbetur në fushë.

ZYLYFI — Sa ka data sot?

ALIU — Një tetor.

ZYLYFI — Ohuuuu!.. Kemi kohë. Gjer më tri-dhjetë janë dhe 29 ditë përpara.

ALIU — Jo, or jo, s'i lë unë, i kam shënuar në kalendar. (*Niset për të ikur dhe e ndal një zë nga jashtë*)

ZËRI — Zylyf, trenjtë për shtëpinë të erdhën nga Përmeti, po t'i kanë lënë poshtë në xhade.

ZYLYFI — (*i shqetësuar*) Vërtet thua?! (*Nisët*)

ALIU — Ku vete Zylyf?

ZYLYFI — Ika të marr trenjtë.

ALIU — Sa është data sot?

ZYLYFI — Një tetor.

ALIU — E po, ke kohë, ke dhe 29 ditë përpanta.

ZYLYFI — Ç'thuas more kokë. Kohën s'e ke në dorë; ja, doli lumi, i vuri përpara e ç'të bëj pastaj?

ALIU — Po t'i shënosh në kalendar, s't'i merr.

DIALOG ME PORTIERIN

PERSONAZHET:

Portieri

Burri

Drejtoresha

(Te portieri i ndërmarrjes N. afrohet një burrë i moshuar)

PORTIERI — (atij) Ç'urdhëroni?

BURRI — Desha të shkoj pak në drejtori.

PORTIERI — Nga vini dhe përsë?

BURRI — Vij nga qyteti dhe dua të bisedoj pak me drejtorin.

PORTIERI — (i habitur) Me drejtoreshën thuaj:

BURRI — Si, grua?.. Ë hë, lëre, s'merrem dot vesh me gra unë... (Niset për të ikur dhe kthehet përsëri) Shpjerme te sekretari i Partisë.

PORTIERI — Nuk është burrë, po grua.

BURRI — Edhe ai?.. Lëre. Atëherë më shpjerrë te... kryetari i komitetit profesional.

PORTIERI — Te kryetarja e komitetit profesional, thuaj.

BURRI — Mos u tallni, ju lutem!.. More, more, po këtu kanë zënë e kakarisin pulat, shyqyr që paskan lënë një kokosh plak te porta.

PORTIERI — More, merr pjesë në konferanca ti? A e këndon gazetën?

BURRI — Pse?

PORTIERI — (*i papërmembajtur*) Se qenke fare tapë nga politika. Po nuk ke marrë vesh, more lumëmadh, se ç'bëhet sot për ngritjen e gruas në përgjegjësi?

BURRI — Kam marrë, ore, kam marrë, po ashtu e kam punën. (*Hyn drejtoresha*)

PORTIERI — Shoqja drejtoreshë, ky shoku edhe do, edhe s'do të takohet me ju.

DREJTORESHA — (*atij*) Urdhëroni, ç'farë kishit?

BURRI — (*ngurron*) Jo, s'ka gjë... Tani do të jeni me punë, një herë tjetër.

DREJTORESHA — Ashtu është, po s'ka gjë, po kthehem dy minuta. Hajdeni brenda!

BURRI — Jo, s'ka gjë, ta them edhe këtu.

DREJTORESHA — Urdhëro!

BURRI — E di si është puna... Unë...

DREJTORESHA — Folni!

BURRI — Kam blerë një kamineto, nga këto që prodhon uzina juaj, mirëpo se ç'ka një difekt dhe sa ndizet, shuhet dhe desha...

DREJTORESHA — E kuptova, bjereni këtu ta shikojmë dhe ta rregullojmë.

BURRI — (*i gëzuar*) Domethënë rregullohet?

DREJTORESHA — Posi. (*I jep dorën dhe pastaj largohet*)

BURRI — (*duke ndjekur me shikim drejtoreshë*) Ju falemnderit, shoqja drejtoreshë!

PORTEIERI — (*i shkon nga pas mengadalë*) E u more dot vesh?

BURRI — (*duke u larguar i gëzuar*) Të tilla makar t'i kesh!

RAKIP KORDHA NË MBLEDHJE

(Monolog)

Thonë se gruaja ka mbyllur shejtanin në shishe. Nuk e kam besuar, se thoshja që edhe gruaja më e zgjuar ka mend më pak se një zog pate, po këtë radhë na mbylli edhe ne. More, po na zunë frymën fare në mbledhje. S'na lanë të ngremë kokë. I mbanin iso njëra-tjetrës.

«Do të flas që ç'ke me të», — tha Mazikja. — Folë moj, folë, po shkurt se na sëmure, thashë mengadalë. — «Si the ti, shok, atje?» — ma preu. E piava! Rri qerrata, thashë, se të bëri tabelë qitjeje. — «Unë, more shokë, tha, s'kam asnë ndihmë nga burri. Vij nga puna, dhe laj, fshij, gatuaj, kurse burri vë këmbët te kërcuri i zjarrit e pi raki. Kurrë nuk më mbushi një gjym me ujë, pa le të tjerat. Jemi bërë në një hall, siç na shihni....» Ç'hall moj, desha t'i thoshja; ty, po të të hipë njeriu në zigj, e thyen fare drurin e zigjit, të janë bérë faqet sikur ushqehet me thelpinj. Pa shih Heqon, si karkalec, si kec i shtirë. Po lëre thashë, hiq e mos e këput. Mirëpo ajo e këputi dhe një të vërsulur mua: — «Pse Rakip Kordha, tha, në punë s'del e vjen vërdallë fshatit?.. Ku ka zjarr e ku del tym, ku ja bën daullja

bym». Një të hipur në kokë më bëri, e m'u tendosën nervat si ato telat e violinës, që po t'i ngasësh një çikë, ting-ting-ting ja bëjnë. Yxhym, i thashë vetes, dhe një të ngritur bëra. Po sa bëra gati t'i hiqja këmbëzën fjalës, u ngrit Zibua dhe më iëshoi një bombë që nuk e kuptova fare si u ula. «Rakip Kordha lëshon poshtë e përpjetë, — tha ajo, — edhe fjalë të tilla si: Zoti kur ndau punët, burrit i dha dyfekun dhe gruas litarin. Por duhet ta dijë Rakip Kordha, se sot edhe dyfekun edhe litarin do t'i mbajmë të dy, burrë e grua!» Ma ndezi keq. U bëra sikur më kishe hedhur gjymin me ujë të ftohtë në kurriz në kërthizë të dimrit. Thashë se me kaq mori fund, po kur ju drejtua gruas: «Folë, ti, Hamide, a janë të vërteta?» U ngrit ajo, ja bëra një herë më shenjë: Mos, se ta përdrohda kokën si të zogut! Por ajo as që më vështroi fare dhe pët, pët, pët iu afrua presidiumit. « — Do ta them se s'e mbaj dot, tha ajo. Ato që u thanë për Rakon tim, janë të vërteta...» dhe filloi të m'i hiqte pendët një nga një. Pika që s'të bie, thashë. M'u duk sikur më ra tavanë dhe m'u bë tym përpara, sikur kisha pirë tri kile raki. Dola nga mbledhja si një i dehur, harrova rru-gën (*spektatorëve*) Si të bëj, more vëllezër?.. Nga t'ja mbaj? Sikur ua hapëm shumë synë!.. Hajde mbaje gruan tani! (*Imiton*) Rakip, mbush gjymin me ujë!.. Rakip, laj një çikë pjatat!.. Rakip, mba vajzën!.. Na ra si pëlliembë pas kokës kjo. (*Drejtohet nga sella*) Ramo, ç'thua?.. Ke ftohtë, ë? Mos e ul kokën. Furtunë e fortë, që në Tepelenë të fryjë, këtu ftohem ne. (*Hyn Hamideja*)

HAMIDEJA — Rakip, sa të marr bukën për nesër, do të shkosh të marrësh një çikë vajzën në çerdhe?

RAKIP — (me vete) Nisëzat (asaj) Me pyetje
e përgjigje e ke?

HAMIDEJA — Po.

RAKIP — (me vete, duke numëruar gishtë-
rinjtë S'vete... vete, s'vete e... vete. U dogja dhe
këtu.

HAMIDEJA — C'thua ashtu?

RAKIP — Na bëtë të fjalosemi me... (ngadalë)
vete.

HAMIDEJA — Me vete?

RAKIP — (dredhon) E, moj, e, do të vete
them. (Ikën me të shpejtë).

RRETHEQARK PAS QANIUT

PERSONAZHET:

Saliu	I pari
Gruaja e Qaniut	I dyti
Qaniu	I treti

(Në paraskenë vrapon Qaniu, Aliu mundohet ta ndalojë.)

SALIU — Qani, je në rregull, vëlla? Rrugët e pazarit nuk janë pistë vrapimi!

QANIU — (me të shpejtë) Po të pyeti njeri për mua, thuaji: «Nuk e pashë».

SALIU — Pse ore, si e ke hallin? Folë!

QANIU — (duke ecur) Kaq të them, se s'kam kohë (ikën) (*Dikush hyn me nxitim*)

I PARI — (Saliut) Të lutem, e pe gjë Qaninë nga shkoi?

SALIU — (i hutuar) Si të të them... Pse, çfarë e do?

I PARI — Më vjen turp të ta them.

SALIU — Ndonjë skandal?

I PARI — (bën me dorë) Më thuaj, andej apo këndej?

SALIU — Prit! (*Bën disa lëvizje me duar djathtas, majtas, lart, që ai i pret si sinjale*) Këndeji!

I PARI — Ka shumë?

SALIU — Po të ecësh me 40 në orë e arrijte. (*Pasi i pari është larguar*) E more Qani, ç'ke bërë, more ditëzi. (*Hyn i dyti*)

I DYT — (*mezi merr frymë*) Të lutem, e pe gjë...

SALIU — (*e ndërpërt*) Qaninë?

I DYT — Po. Nga shkoi?

SALIU — Prit, o vëlla!.. Largohu pak! (*Salu vë bilbilin në gojë dhe drejton si polic në udhëkryq*) Këndeji... Ka më të tjerë?

(*Hyn i treti, një mesoburrë*)

I TRETI — Ka mundësi të pyes për diçka?.. Mos e pe gjë një burrë me një kasketë në kokë, me pallto me katrorë, që ka hundën pak të shtypur?

SALIU — Qaninë?

I TRETI — Po, Qanon.

SALIU — (*i jep shenjë me dorë dhe i bie bilit*)

I TRETI — Mos u tallni, ju lutem!

SALIU — Kanë shkuar shumë të tjerë para teje dhe mua m'u desh të bëhem si polic në udhëkryq.

I TRETI — Kérkonin Qanon?

SALIU — Po, do t'i takosh?

I TRETI — Posi, patjetër, se....

SALIU — Meee vrap! Këndeji (*Pasi ikën dhe i treti*) Mallëkuar qoftë minuta që të takova, more Qani!.. Paske ngritur gjithë qytetin në këmbë. (*largohet*)

I PARI — (*duke hyrë në paraskenë*) S'është, si m'u tha goja dhe s'e pyeta për ku shkonte.

I DYT — (*Nga krahut tjetër i skenës*) Prapë do të na shpëtosh.

I TRETI — Ah, more Qano, zhivë na u bëre, a i zi!.. (*U drejtohet atyre*) Ju lutem, more shokë, mos e patë gjë Qanon?

I PARI — Atë kërkoj edhe unë, o xhaxha.

I DYT — (*pyet ata*) Edhe ju pas Qaniut?

I TRETI — Pse, edhe ti?!

I DYT — I poshtëri!

I PARI — Maskarai!

I TRETI — Ah, Qano qafiri!.. (*Atyre*) Mos ju ka marrë para borxh?

I PARI — Një qindshe të re.

I DYT — Pesëdhjetë të reja.

I TRETI — Mos u qani, se ka edhe më keq: dy mijë lekë të vjetra ose dyqind të reja mua! M'u lut, se kishte një fëmijë të sëmurë dhe ja dhashë, po mbushi një vit dhe s'kujtohet.

I PARI — Sa herë që merr rrögën na fshihet.

I TRETI — More, për mua është bërë si i vdekur, s'ja kam parë fare surratin.

I DYT — Dëgjoni shokë, sot ai ka marrë rrögën, o do t'ja marrim sot, o hiç.

I TRETI — Bashkimi bën fuqi, po ç'të bëjmë?

I PARI — (*duke parë orën*) Ai tani do jetë në shtëpi për drekë.

I DYT — T'i rrethojmë shtëpinë. Kur të dalë për zyrë e kapim.

I PARI — Mendim shumë i mirë.

I DYT — Një te porta, një nga deriçka dhe një nga muri i kopshtit. Vetëm, gëk!

I TRETI — Xhevahir mendim! Nisuni djema

(*Largothen njëri pas tjetrit të tre. Hapet perdja. Në skenë duket porta e shtëpisë së Qaniut*) Te porta do të rri unë, se jam më i thekur!

I PARI — Po të dalë, folna! (*I pari dhe i dyti ikin, shkojnë nëpër vendet e caktuara. Pasi kalon një kohë në përgjim*) Vajti ora për të dalë dhe nuk po del.

I DYTE — Mos nuk është në shtëpi?

I TRETI — Fshihuni ju, se e marr vesh unë këtë gjë. (*Shkon i bie portës dhe, pasi largohet, del një grua*)

GRUAJA — Urdhëroni, ç'dëshironi?

I TRETI — Ishte një fëmijë dhe kërkonte Qanon, kish një copë letër në dorë, mos e kanë dërguar gjë nga zyra?

GRUAJA — (*me zë të lartë*) Qanii! Pa dil se të kërkon një djalë.

QANIU — (*gruas*) Ku është?

I TRETI — Unë jam, more Qano. Po kur m'i more s'më dhe as këpucët e tua që të mos kisha grisur të miat, po u bë një vit, more Qano!

QANIU — S'të njoh fare kush je (*Shkon nga pas gruas dhe ja bën me shenjë të mos flasë*).

I PARI DHE I TRETI — (*dalin*) Po ne na njeh?

GRUAJA — Ç'janë këta, Qani? (*Qani ua bën me shenjë mos të tregojnë*)

QANIU — (*gruas*) Këta janë... (*Pyet të tretin me shenjë, sa të kam*)

I TRETI — Dy të mira.

QANIU — (*duke i dhënë lekët me marifet*) Dy shokë të punës janë, moj grua.

GRUAJA — (*duke shikuar të tretin*) Po ky?

I TRETI — Roja i portës. (*Qaniu pyet të dytin, sa të kam*)

I DYTI — Gjysmë ose 50 të reja.

GRUAJA — (*hutohet*) Si gjysmë?

I DYTI — (*duke u afruar për të marrë lekëti*)
Gjysmë dite punon ai, se ruan natën dhe është 50
vjeç (*Qaniu pyet të parin*) Sa të kam?

I PARI — (*pasi i ka nxjerrë Qaniu një 25*)
Edhe tri të tjera që të jesh brenda.

QANIU — (*duke ja bërë me shenjë që nuk ka më*)

GRUAJA — Ç'farë flisni, nuk ju kuptoj, përsë flet shoku, Qani?

QANIU — Mos u përziej në sekretet e zyrës.

GRUAJA — (*e revoltuar kthehet nga Qaniu*)
Ç'farë sekretesh... (*i mbetet fjala në gojë kur i shikon lekët në duar*) Ç'janë këta lekë?

QANIU — (*duke ja dhënë*) Jepja shokut!

I PARI — Duhen edhe tri të tjera.

QANIU — Nesër, ç'ke ti, nuk më beson?

I PARI — Kam pritur një vit të tërë.

GRUAJA — Borxh?! Prandaj më vije natën
në shtëpi i pirë dhe rrrogën ma jepje gjithnjë gjysma-gjysma, duke më gënjer se gjoja plotësoje deficitin! Turp të kesh! Unë këtë do ta bëj problem
në kolektivin e ndërmarrjes. (*Nxjerr e plotëson lekët për të parin*) Urdhëroni! (*Ata të tre largohen ndërsa Qaniu mbetet si i ngrrirë*)

I TRETI — Rrethimi mbaroi, qarkullimi është
i lirë.

E K Z E K U T I M I

PERSONAZHET:

Tarja
Shabani
Plaka

(Në paraskenë hyn Tarja, një i ri fshatar, i ngarkuar me litarë me ngjyra, me dimensione të ndryshme. Litarët i ka hedhur në të dy supet, kryq e tërthor)

TARJA — (spektatorëve) Mos kujtoni se më kanë lidhur? (Qesh) Jo, jo, more jo. Unë sot... (Hyn Shabani)

SHABANI — (e ndërpret) Tare, ç'ke bërë kështu, o i zi?

TARJA — Siç e dini, në fshatin tonë u hoq tërkuza. Unë kalova në çdo shtëpi dhe i mblohdha që t'i humbasim e mos u mbetet nam e nishan këtyre nëpërkave, që kanë kafshuar me vjete të tëra supet e grave tonë.

SHABANI — Dhe ç'do t'i bësh?

TARJA — Do t'i ekzekutoj. Vendimi është i

formës së prerë: djegja në zjarr. (*Nxjerr një tērkuzë*) Kjo!

SHABANI — (*ndērhyn*) Pērse akuzohen?

TARJA — (*duke lexuar vendimin*) Tērkuza e Manushe Banushit, pesë vjeçë, e gjatë katër metra e ca, ngjyrë e kuqe, mpleksur në formë gërshtet me lesh dhie. Bëri gjatë jetës së vet tri herë operacion: Nyja e parë u bë kur Manushja, pēr t'u treguar shoqeve forcën, zotësinë e saj, ngarkoi nga pazari pēr në fshat një sepet nusërie. Nyja e dytë, kur ngarkoi 60-70 kg. dru të njoma nga mali dhe nyja e tretë, kur ngarkoi bucelen 40 okë. I shkau këmba, e zuri bucela nën vete dhe qëndroi një javë në dyshek duke pllakosur mesin me jaki.

SHABANI — (*duke hedhur tērkuzën*) Kriminele!.. Të erdhi fundi.

TARJA — (*merr tjetrën*) Tērkuza e Sumbull Rodhezës, dhjetë vjeçë. E gjatë 5 metra dhe e gjerrë sa një sulinë uji, kërp Shkodre safi. Ka plagosur dhe handakosur me dhjetëra herë Sumbullen. Një herë i mbledhi një xhumbë në zverk sa një kokërr hudhre. Një herë tjetër, nga barra e rëndë, i zuri frymën në mes të rrugës dhe atë ditë Sumbulla e nëmi dhe e shau, deshi dhe ta rrihte, mirëpo i shoqi, Hysua, që i vinte pas me sopatë në dorë, «mos!» — i tha — «se na duhet edhe pēr nesë». Akuzohet se ka ngarkuar dhe gra e vajza të tjera fshehurazi.

SHABANI — (*duke e flakur*) Mëkatare! Kjo duhet përvëluar në flakë.

TARJA — (*pasi ka marrë tērkuzën tjetër*) Tērkuza si ngjyrë ylberi e Varvara Xhaxhos. Kjo tērkuzë e pafytyrë, e pacipë dhe pa gjak në faqe, ka

kryer masakra të pashembullta, duke ngarkuar për tre vjet rresht Varvarën 16-vjeçare me murriza, me ferra e me driza.

SHABANI — Duket kjo, se dhe nga fytyra është si e shplarë. (E hedh) Te shoqet!

TARJA — (tjetrës) Tërkuza e Vasillo Shurdhës, siç e shikoni e rjepur sikur e ka zënë zgjebja, 15 vjet ka bërë ç'ka dashur. Ka ngarkuar Vasillo 55-vjeçare me dërrasa, trenj, gurë, etj. Kjo terkuzë kishte 15 ditë që dergjej pa shpresë, Vasilua e fërkoi me kanfor, i hodhi kupa, i hodhi sinap, thonë se kishte plevit kronik. Tani, siç e shikoni, mezi merr frymë. (Nga sella) Vasillo, si thua ti, t'i vëmë shkrepsen?

SHABANI — Se sëmundja e saj është ngjitëse. (E merr me shkop dhe e hedh te shoqet)

TARJA — (merr tjetrën) Edhe kjo...

SHABANI — Mos folë! Te vendi.

TARJA — Tjetra.

SHABANI — Në zjarr!

TARJA — Edhe kjo.

SHABANI — Në benzinë ta djegim.

TARJA — (i jep të fundit) Ujdisma dhe këtë nepërkë!

SHABANI — (e merr në dorë, bën sikur i ngre kokën) U, kjo më vdiq në duar nga frika. (E hedh) Tjetër.

TARJA — S'ka më. (Që të dy fillojnë të hedhin mbi tërkuza benzinë dhe bëjnë gati shkrepsen për t'i ndezur)

TARJA — (që diçka dëgjon) Pa prit, dikush po vjen. Hajde të fshihemi! (Hyn një plakë)

PLAKA — (Mbi togun më tërkuza, fillon kën-

gë sipas melodisë së këngës vlonjate: «Te pjerzu-
lla me avlli».)

Moj tärkuzë, qofsh lanet
Na more shpirtin kaq vjet
Si e tha dhe Xha Idrizi
Do na gjej rehat kurrizi
Si nga druri dhe murrizi
O po xha Idrizi.

S'jemi kafsh', dreqi ta marrë
Ngarko mushkën dhe gomarë
Rri pran' zjarrit në buxhak
Do vijn' drutë me vandak
O po tak-tak-tak.

TARJA DHE SHABANI — Të lumtë nëne!

BIJA IME

PERSONAZHET:

Xha Hasani
Oficeri
Vajza e xha Hasanit

(*Në paraskenë duket xha Hasani me një torbë në dorë*)

XHA HASANI — (*duke ju përgjigjur dikujt jashtë skenës*) Pse vetëm të rinjtë dhe burrat, edhe pleqtë në ndihmë të plakave. (*Ndalet dhe numëron lekët*) 100 mishi, ja dhe 20 domate... U bënë një-qind e... (*Hyn një oficer*)

OFICERI — Xha Hasan!

XHA HASANI — O bir i xha Hasanit (*Tako-het*) Po ç'u bëre, more bir, kemi dy ditë që nuk jemi parë dhe më ke lënë si të shurdhër. Mbrëmë rrija me plakën te porta dhe të kujtuam.

OFICERI — Me punë, xha Hasan, këto ditë kemi patur qitje.

XHA HASANI — Aman ore, po si nuk më more edhe mua një herë, nuk do t'ju turpëroja. Tërë

jetën nuk më ka ngrënë njeri në nishan me pushkë.

OFICERI — (*duke qeshur*) Kishim qitje me top, xha Hasan.

XHA HASANI — Me top?.. S'e bëj dot. Po a qëlluat mirë mbi armikun?

OFICERI — Atje ku ranë predhat tonë, këmbë armiku nuk mbeti.

XHA HASANI — A më ju lumtë syri i pushkës, më fal, i topit. Po hajde tanë, dhe tregoi xha Hasanit, kush doli më mirë nga rinia e lagjes sonë?

OFICERI — Mbi të gjithë një vajzë, o xha Hasan.

XHA HASANI — Vajzë?!.. E pabesuar... Kush e di ç'farë race do të ketë qenë.

OFICERI — Një vajzë e zakonshme.

XHA HASANI — Leri ato ti, se s'ma hedh dot mua. Edhe në qoftë se ka bërë vaki, do ketë qenë ndonjë azgëne ajo.

OFICERI — Jo. Të paktën, si gjithmonë besomë! Dhe çfarë mrekulli, të trija predhat e saj në shenjë.

XHA HASANI — Vajzë dhe të qëllojë kaq mirë... Patjetër ajo do të ketë qenë nga derë pushke.

OFICERI — Të gjithë derë pushke janë sot, të gjithë barutin thatë e mbajnë, djem e vajza, burra e gra...

XHA HASANI — (*e ndërpert*) Pleq e plaka, edhe ne nuk na e ha qeni shkopin, po të jetë nevoja.

OFICERI — Ashtu është xha Hasan! (*Hyn një vajzë*)

VAJZA — Baba!

OFICERI — Ja, kjo është vajza për të cilën të fola.

XHA HASANI — Bija ime?.. Rrofsh, se ma ke zbardhur faqen, bija ime! (*E përqafon dhe pastaj i drejtohet oficerit*) Dëgjo, kapedan, tani edhe në vdeksha kam se kë të lë, dhe këtë radhë, jo me pushkë, por me top.

BERBERËT KONSERVATORË

PERSONAZHET:

Shabani

Serveti

Manushaqja

Klienti I

Klienti II

{
(Në berberhanë duket Shabani dhe Serveti. Të dy janë ulur dhe bisedojnë)

SHABANI — Ta priste mendja që një ditë do të shihej tek ne grua, që kërkon të marrë briskun e gérshérën në dorë pa pikë turpi!?

SERVETI — Ty e mua s'ma priste, po ja preu asaj.

SHABANI — Ja preu, po na preu edhe nafakën, kismetin e fémijës.

SERVETI — Lëre se ç'do të vejë. Gruaja sulmoi edhe këtë pozicion, që gjer më sot konsiderohet i papushtuar.

SHABANI — Dhe po ja mori një çikë dorën kjo dhe të fillojë t'i ëmbëlsohet, prit kur të vijnë thëllëzat e tjera dhe mua e ty lumi që na mori.

SERVETI — Shirat e para të vjeshtës filluan, pritet dimri i fortë, prandaj bëju gati për mbrojtje.

SHABANI — Si do të mbrohem?.. Duhet përpunuuar taktika.

SERVETI — T'ja bëjmë humnerë punën këtu.

SHABANI — Të tmerrshme!

SERVETI — Që të mallëkojë njëqind herë në ditë çastin që erdhi këtu dhe të dorëzohet pastaj pa kushte.

SHABANI — (*nxjerr një letër*) Ja dhe rregullorja e punës së saj si nxënëse: e para, të rrijë gjithë ditën në këmbë.

SERVETI — Nën pretekstin se duhet ta forcojë muskulaturën, të stërvitet, se puna jonë e tillë është.

SHABANI — E dyta: Në çastin kur klientët mbarojnë së qethuri ose së rruari dhe, duke u ngritur nga karrigja shpresohet se mund të lëshojnë në dorë të ustait ndonjë 50-qindarkshe, duhet nisur patjetër me ndonjë punë.

SERVETI — Nën pretekstin se infektohet.

SHABANI — E treta...

SERVETI — Të tretën lëre se erdhi (*Hyn Manushaqja*)

SHABANI — Erdhe Manushaqe?

MANUSHAQJA — Erdha, po punë s'mbarova dot, se nuk ishte asnjë në zyrat e kryesisë.

SERVETI — Mos u mërzit, punë e mirë në gjashtë muaj bëhet. (*Manushaqja ulet*)

TË DY — Mos u ul!

SHABANI — Merre punën shtruar Manushaqe, i thonë brisk këtij dhe këtu ke të bësh me jetën e njerëzve.

MANUSHAQJA — Po vajta kaq kohë shoku Shaban, të paktën një qethje koke të një fëmije me maqinë kam besim se e bëj.

SERVETI — Të duket, po nuk është e lehtë, se në vend që t'ja presësh flokun, do t'ja heqësh një nga një dhe do të tmerrosh djalin e botës, që të mos qaset në derën e berberhanës edhe kur të bëhet 30 vjeç. Dhe kështu i humbet kooperativës dhe vetes një myshteri ndofta me leverdi.

MANUSHAQJA — Po më jepni një herë maqinën në dorë dhe ju më qëndroni pranë të më mësoni, po s'punova s'kam si të mësoj.

SHABANI — Prova në kokën e njerëzve nuk bëjmë, i thonë maqinë me korrent asaj dhe mjaf-ton një pakujdesi e vogël dhe fap, hyn si plug në kokën e njeriut.

MANUSHAQJA — Po si do të mësoj, më thoni, nga duhet ta filloj.

SERVETI — Më duket se e humbe durimin, ohu-he sa ka zanati, moj vajzë. (*Manushaqja ulet e mërzituri*)

SHABANI — Ja, prapë gabim. Mos u ul, duhet të forcosh muskulaturën.

SERVETI — E dyta: Merrni gëershëren. (*Ajo merr gëershëren*) Bëni s'kur prisni me shpejtësi. (*Ajo fillon*) Ashtu, vazhdoni sa t'u forcohen gishtërinjtë.

MANUSHAQJA — Sa do të vazhdoj kështu? (*Hyn një klient*)

SHABANI — Urdhëroni, i dashur!.. Të qethur?

KLIENTI — Të qethur dhe të rruar.

SHABANI — Uluni!.. Manushaqe, pecetat! (*Manushaqja vrapon të marrë pecetat*) Manushaqe!.. Briskun mbi tavolinën tjetër. (*Ajo shkon ja bie. Hyn klienti i dytë*)

SERVETI — Urdhéroni... Të rruar?

KLIENTI — (duke u ulur) Një të rruar, po pak shpejt, se nxitoj pér në mbledhje.

SERVETI — Si të urdhéroni, gati... Manushaqe, pecetat!

SHABANI — Manushaqe, letër! (*Manushaqja pasi i shpie pecetat nxiton pér letër*)

SERVETI — Manushaqe, rripin ta rrähim briskun. (*Ajo nxiton në krahun tjetër*)

SHABANI — Shishen e kolonjës Manushaqe, shpejt!

MANUSHAQJA — Erdhi!

SERVETI — Manushaqe, sapunin. (*Ajo qëndron në vend*)

SHABANI — Manushaqe preji një markë shokut!

SERVETI — Manushaqe! (*Pasi shikon që ajo nuk lëviz më*) C'qëndron, hidhju punës!

KLIENTI — (berberëve) Më falni, kjo shoqja çfarë pune kryen këtu?

SERVETI — Nxënësja e parë grua në berberhanë.

SHABANI — Hyrja e saj këtu konsiderohet si hyrja e Gagarinit në kozmos.

KLIENTI II — Ju e mësoni apo e torturoni?

TË DY — Pse?!

MANUSHAQJA — Sepse doni që midis jush të mos hyjë femër, se keni frikë se ju merr zanatin. Kërkoni që të më mërzitni dhe unë të iki, po i keni bërë keq llogaritë.

TË DY — S'është e vërtetë!

KLIENTI — Ashtu është, shoqja ka të drejtë.

SHABANI — Ju pse ndërhyni në punët tonë të brendshme?

KLIENTI II — Sipas jush duhet të mos flasim?..
Të heshtnim e të pajtohem me qëndrimin tuaj që
kërkon t'ja bëni të mërzitshëm zanatin një gruaje
që hyn e para këtu? Ne do ta ndihmojmë atë.

SHABANI — Dhe ne po e ndihmojmë dhë po
e mësojmë.

MANUSHAQJA — Ju s'më shihni dot me sy
dhe prisni me padurim çastin që unë të iki. Po unë
s'jam njeri pa njeri, kam me dhjetëra të tjerë
që më ndihmojnë.

SERVETI — Për të marrë zanatin s'ka kush të
ndihmon veç nesh.

TË DY KLIENTËT — Do ta ndimojmë ne.

SHABANI — Në c'mënyrë, ju s'jeni berberë?

KLIENTI II — Ne dhe shokët tanë si dhe
shokët e shokëve tanë do t'i japim Manushaqes
gérshérën dhe briskun në dorë duke pëlqyer të
qethemi e të rruhem gjithmonë te ajo. (*Ata dalin*)

MANUSHAQJA — (atyre) Ju falem nderit, do
përpinqem të justifikoj besimin.

SHABANI — Ç'ishte kjo, more Servet?

SERVETI — Të rruar e të qethur me shëndet!

MARATONISTËT E KOMUNALES

PERSONAZHET:

Bojaxhiu	Myrtua
Pompieri	Drejtori
Taqi	Shërbyesja

BOJAXHIU — (*pasi hyn në zyrën e drejtorit*)
Shoku direktor, e matëm. Janë për të lyer 600 m².
Brenda dy ditësh skuadra mbaron.

DREJTORI — Mirë, vetëm kujdes!

BOJAXHIU — Mos kini merak, do ta bëjmë
xixë, pasqyrë fare. Nderojmë markën e komunales.

DREJTORI — Ku i keni shokët e skuadrës?

BOJAXHIU — Urdhëro!. . (*Tregon pompierin,
një djalë delikat*)

DREJTORI — Vetëm ky??

BOJAXHIU — Punon sa për shtatë, gjithë
muskulaturë është.

DREJTORI — E shoh... Atëherë filloni nga
zyra ime më parë. (*Fillon që të nxjerrë karriget
i ndihmuar nga bojaxhinjtë dhe nga shërbysesja*).

BOJAXHIU — (*drexitorit*) Si e do? Me pudër,
sqafidh, apo vetëm me sherbet?

DREJTORI — (*buzëgaz*). Sa më mirë. (Del)

BOJAXHIU — (*fillon të hipë në një shkallë druri*) Me hair, atëherë. (Shokut të vet) Sot na vate mirë, Baçi, tre fronte hapëm, një në PTT, një në komitet të qytetit dhe një këtu. E vumë normën në mes si Skënderbeu ushtritë turke në betejën e Torviollit. 200 përqind sot.

POMPIERI — I hyre mirë asaj historie ti, unë gjëkundi. M'u bë mendja dhallë me data e me vite dhe prapë i ngatërroj.

BOJAXHIU — Do ndihmë?

POMPIERI — Aman!

BOJAXHIU — (*i hipur mbi shkallë, kthehet nga ai*) Do të kesh parasysh të thuash gjithnjë esencën. Ja, përshtembull, do t'i flasësh mbi rënjen e Trojës, që ishte katastrofike për trojanët. Grekët, me dhelpëri i vunë në gjumë trojanët dhe, në mes të natës, duke dalë nga barku i kalit të rremë, u hynë me shpata në dorë trojanëve nëpër dhomat e gjumit. Ç'gjullurdi. (Përdredh pompën si shpatë) Fap, fup-fiu kokat (*pompieri, për t'u ruajtur nga boja, shtrihet në shesh, ndërsa ai vazhdon të imitojë luftën me shpata*)

POMPIERI — Aman ore, s'mbaroi akoma luf-
ta e Trojës, se më plasën sytë nga gëlqerja.

BOJAXHIU — E mësove?

POMPIERI — Ujë fare, s'do ta harroj gjithë jetën. (*Ngrihet duke fshirë sytë. Hyn brenda një bojaxhi tjetër*)

TAQI — Usta, e hëngrëm!.. Në frontin e dy-të, disfatë.

POMPIERI — Këtu katastrofë.

BOJAXHIU — Lërini fjalët! Raporto shkurt dhe qartë!

TÀQI — Drejtori i ndërmarrjes ku punoj më tha: Ku i ke shokët? Sot duhet të mbaroni, se na latë pa punë, përndryshe ju hodha në gjyq shoqëror.

BOJAXHIU — Në gjyq?!.. (*I drejtohet pom-pierit*) Shpejt Baçi, shko si përforcim në frontin e dytë!

POMPIERI — Si urdhëron! (*Ikën bashkë me Taqin*)

BOJAXHIU — (*duke marrë pompën vetë në krahë*) U mbyll edhe kjo e çëra në frontin e dytë. Tani jepi, Liçi! Futi marshin e tretë. (*Fillon të lye-jë me shpejtësi duke kënduar: «Bjeri pompës, bojaxhi, bjeri më t'u thaftë dora».* Hyn shërybesja)

SHËRBYESJA — Pa shiko, atje te rrëza e murit sikur nuk ka marrë mirë.

BOJAXHIU — (*duke kënduar*) Mos e mëso ustanë, se i merr zananë.

SHËRBYESJA — Nuk të mësoj, të keqen, po meqë e pashtë, të thashë... Sikur shumë vjasesh?

BOJAXHIU — Jemi në kohën e shpejtësive kozmike, s'ke marrë vesh ti?

SHËRBYESJA — Po shokun, ç'e bëre?

BOJAXHIU — Pregatit garniturën.

SHËRBYESJA — Ç'është kjo garniturë?

BOJAXHIU — Sqafidh për mur.

SHËRBYESJA — E, me ty s'merem dot vesh, mor djalë, ti fjalosesh katër e pesë. (*Hyn Myrtua i nxituar*)

MYRTUA — Shpejt Liçi, se plasi në frontin e tretë.

BOJAXHIU — Mos more! (*Zbret nga shkallët*)

SHËRBYESJA — (*që nuk kupton*) Mos na i ho-

qët fundomën kazanit? (*Duke dalë*) Edhe ju, tra zo e trazo... (del)

MYRTUA — (mezi flet) Shpejt, gjendja është kritike. Më thanë: «Ku i ke shokët, keni dy ditë dhe akoma s'po mbaroni. Po nuk e mbaruat sot gjer në drekë, do t'ju bëhen në ngarkim shpenzimet.

BOJAXHIU — Nisu!

MYRTUA — Do të vish ti?

BOJAXHIU — Përpara, të thashë! Dhe mengadalë, mos na shikojnë e na dëgjojnë. Këndeji! Hiqi këpucët! (*Kur ata dalin, hyn në zyrë drejtori me shërbysen*)

DREJTORI — Uaaa!.. Ku vanë? U bënë si njeriu i dëborës, duken e zhduken. (*Duke shikuar muret*) Ç'është bërë kështu? Janë bërë muret vija — vija, si basmë pizhamash.

SHËRBYESJA — I thashë: Mos u shpejto, more djalë! Po më tha: Jemi në kohën e shpejtësive kozike.

DREJTORI — Ashtu? Po ku vanë?

SHËRBYESJA — U erdhi një shok dhe u tha.

Plasi në frontin e tretë.

DREJTORI — Ç'plasi, moj?

SHËRBYESJA — Pa di dhe unë? Thashë mos më kishin shpuar fundomën e kazanit.

DREJTORI — (i menduar) Pelivanllëqet e komunales. Kanë vajtur e punojnë në vende të tjera. (*Shërbyeses*) Tani do të shkoj t'i bie unë. Ti, priti këtu dhe mos i lërë të ikin më. (Del)

SHËRBYESJA — More, po erdhën, do t'uambyll derën dhe, në daçin le mos punojnë pastaj (*Bie zilja e telefonit*) Kush je?.. P.T.T.-ja?.. Bojaxhinjtë?.. Jo, nuk janë këtu. Edhe nga ne

ikën... Ku di unë? (*Dëgjohen bojaxhinjtë*) Erdhën,
më ngjan. (*Hyn bojaxhiu dhe pompieri*)

BOJAXHIU — (*pasi hyjnë në zyrë*) Shpejt,
Baçi!

SHËRBYESJA — Po ku ishit, more?

POMPIERI — Te të gjithë nga një çikë, jo ca
të nënës, e ca të njerkës.

SHËRBYESJA — Mirë, mirë, po hyrë brenda!
(*U mbyll derën*)

BOJAXHIU — (*Thërret*) Mos e mbyll derën!

SHËRBYESJA — (*nga jashtë*) Kur të mbaroni,
folmëni, se jua hap.

BOJAXHIU — (*shokut*) More na ngatërruan
keq ata të drejtorisë sonë.

POMPIERI — Kemi gjashtë skuadra boja-
xhinjsh, thonë. Po ku i kanë? Të gjithëve u japin
fjalën (*Hyn Taqi*)

TAQI — (*i bie derës*) Baçi!.. Liçi!.. Tërmët
nëntë ballësh në frontin e dytë, plasi!

POMPIERI — Akoma s'ja ka bërë bof?!

TAQI — Po dil ti, more Baçi, të paktën.

BOJAXHIU — Na kanë mbyllur si zogjtë në
kuvli, s'na jep vizë për të dalë jashtë Hanko halla.

P A P S E

(Intermexo)

PERSONAZHET:

Karakaqi
Janaqi
Korofillaku
Shefi i asfalise

(Në paraskenë takohen dy punëtorë grekë. Janaqi qëndron në vend dhe herë pas here shikon orën.)

KARAKAQI — (*duke kaluar*) Kalispera Janaqi!

JANAQI — Kalispera Karakaqi!

KARAKAQI — Pse rrini këtu?

JANAQI — Po pres gruan, ka shkuar deri në...

KARAKAQI — Ti e di si është bërë sot gjendja në Greqi. Ç'më rri në gojën e ujqërve, mos pret të shkosh si cjapi te kasapi?

JANAQI — Po s'mund ta le gruan vetëm rru-gëve agapitemu.

KARAKAQI — Më thanë se je përsëri pa punë.

JANAQI — Ç'pyet... Sikur të mos kisha fë-

mijë do t'ja hiqja vetes. (*Dëgjohet një bilbil. Hyn me të shpejtë një korofillak*)

KOROFILLAKU — Mos luani! Jeni të arrestuar!
TË DY — Si?!... Po, pse?

KOROFILLAKU — Mënyra si qëndroni dhe bisedoni paraqet rrezikshmëri. Keni sharë regjimin.

JANAQI — Nuk është e vërtetë!

KARAKAQI — S'kemi thënë asnjë fjalë.

KOROFILLAKU — (*i nxehur*) Papse! Njiheni ju që nga sytë, para!

KARAKAQI — (*duke ecur*) Të thashë, Janaqi.

KOROFILLAKU — Papse! (*Largohen nga paraskena dhe korofillakun e shohim pastaj në një nga zyrat e asfalisej*)

KOROFILLAKU — (*pasi paraqitet*) Qirje! Arrestova dy të dyshimtë që bënin propa...

SHEFI I ASFALISE — (*që është ulur pranë tavolinës dhe diçka shfleton, ngrihet me nervozizëm*) S'më duhen të gjithë; të dyshimtët!

KOROFILLAKU — Ku t'i shpiem, qirje?

SHEFI I ASFALISE — (*ngrihet, hap një regjistër të trashë*) Në burgun «tmerri» sot paradite u zunë vendet. (*Shfleton dhe ecën*) Tri burgjet e Athinës janë rënduar shumë. Burgu i Korfuzit ankohet se ka tepër... Edhe këtu jo... edhe këtu jo... as këtu...

KOROFILLAKU — Në kampin e përqëndrimit, në stadjumin «tu pegnidhju».

SHEFI I ASFALISE — S'ka vend. Është bërë shumë e shtrenjtë biletë.

KOROFILLAKU — Po në stadjumin...

SHEFI I ASFALISE — S'ka vend. Aty lot kamzhiku me rebelët.

KOROFILLAKU — Po atëhere, ku t'i shpiem
qirje?

SHEFI I ASFALISË — (*pasi mendohet pak*)
Në kinemanë numër dy.

KOROFILLAKU — Pse, edhe ajo u mbyll?
SHEFI I ASFALISË — Papse!

LOJA E VDEKJES

PERSONAZHET:

Xhon Shmid	— major i ushtrisë amerikane
Lafer	— toger i ushtrisë mercenare australiane
Tien	— toger i ushtrisë mercenare vietnameze të Jugut
Bob Rek	— toger i ushtrisë amerikane
Adjutanti	

(Ngjarja zhvillohet në Vietnamin e Jugut, në një kohë luftimesh të ashpra. Në zyrën e komandës së batalionit komandanti Xhon Shmid është i preokupuar. Përpara ka hartat e luftimit)

XHON SHMIDI — (Në telefon) Aloo... Kuota 1191 (nuk ka përgjigje) A thua vërtet janë larguar nga kuota në drejtim të qytetit Bien Din? Po pse nuk përgjigjen xhanëm?!

ADJUTANTI — Zoti major! Togerët Bob Rek, Tien dhe Lafer sapo arritën në kampin tonë.

XHON SHMIDI — Triumfatorë! Domethënë operacioni ynë «Trekëndëshi i tehut» po del me sukses!

ADJUTANTI — ?!..

XHON SHMIDI — Folë!.. Triumfatorë?

ADJUTANTI — (ul kokën)?!..

XHON SHMIDI — Të vijnë menjëherë këtu!

ADJUTANTI — (nderon dhe del) Jes!

XHON SHMIDI — Trima të sprovuar si togeri amerikan Bob Rek, togeri nga Australia Lafer dhe trimi e patrioti nga Vietnami i Jugut Tien, nuk ka në asnjë repart të ushtrive tona në Vietnam. (*Hyjnë në skenë Bob Rek, Lafer dhe Tien njëri pas tjetrit. Që të tre janë dërmuar nga grushtet e Ushtrirë nacionalçlirimtare të Vietnamit të Jugut*)

XHON SHMIDI — Ç'është kjo hata?! (*Heshtje*)
Ta shpjegojë shkurt togeri Lafer!

LAFERI — Nga gjithë kompania australiane,
siç e shikoni, kam shpëtuar vetëm unë, zoti major.

XHON SHMIDI — Vetëm ti?!. Nuk i ke ush-
tarët?

LAFERI — I nisën për në botën tjeter!

XHON SHMIDI — Frikacak! Dil përjashta!
Drejt e në togën e pushkatimit! (*Lafer del*) Po ti,
toger Tien?

TIENI — Na dërmuan, zoti major! Kanë armë
të tmerrshme!

XHON SHMIDI — Ç'armë të tmerrshme, mor
frikacak. Armë të tmerrshme disponojmë vetëm ne,
amerikanët. Dhe të gjitha llojet i kemi vënë në përdorim,
por armët duan gisht, duan zemër. Që të
gjithë jeni frikacakë. Ikni si lepujt. Niksoni ynë i
shtrenjtë duhet të ketë me mijëra majora Shmid
për të fituar luftën, në Vietnam. Përjashta, drejt në
togën e pushkatimit! (*Tien del. Togerit Bob Bek*)
Edhe ti, toger i këmbësorisë amerikane na fëlliqe?!

BOB REKU — Na fëlliqen ata, zoti Shmid!..

XHON SHMIDI — Lufta kërkon trima, toger Bob. Duhet të shpërndaheni në secilën fortësë. Duhet të jem unë atje që t'i tregoj Vietkongut rrugën e ikjes. Unë... Unë, major Shmid... I njoftur për trimëri në të gjithë armatën amerikane. (*Dëgjohet një mitraloz fare afër. Që të dy bien barkas me ftyrë nga spektatorët. Mitralozat dhe armët e tjera dëgjohen edhe më tepër*) Më njofto, toger Bob, si u zhvilluan luftimet, se dua të njoftoj urgjent korpusin.

BOB REKU — Sa ra nata, partizanët sulmuan...

XHON SHMIDI — Sulmuan?! (*Krismat afrohen. Këmba dorës ata largohen me shpejtësi nga njëri-tjetri në dy skajet e skenës*)

BOB REKU — Po, po, sulmuan!

XHON SHMIDI — Dhe ju ç'bëtë, toger Bob?

BOB REKU — Ne bëmë atë që po bëni edhe ju tanë, major Shmid!

PASQYRA E LËNDËS

Kompetenti (skeç)	3
Një flakë kashte (skeç)	9
S'ke ç'bën me masën (skeç)	15
Kungulleshkat e anëtarëve të komitetit profesional (skeç)	19
U ngeci sharra në gozhdë (skeç)	23
Familja diskuton (skeç)	31
Dialog në dritare (skeç)	36
Vrava të nesërmen (skeç)	39
Kemi kohë (dialog)	41
Dialog me portierin (dialog)	43
Rakip Kordha në mbledhje (monolog)	46
Rretheqark pas Qaniut (skeç)	49
Ekzekutimi (skeç)	54
Bija ime (dialog)	58
Berberët konservatorë (skeç)	61
Maratonistët e komunales (skeç)	66
Papse (intermexo)	71
Loja e vdekjes (skeç)	74

Tirazhi 2500 kopje Format 70x100/32 Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1970